



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **21.01.2021**, me fillim në ora **10.00**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2020,**
3. **Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2020,**
4. **Informatë rreth punës së KKS-së për gjashtë (6) mbledhjet e vitit 2020,**
5. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës,**
6. **Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P – 71510066 – 00386-1,**
7. **Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2020,**
8. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo e vë në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:
Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka rreth procesverbalit, atëherë nëse nuk ka e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

Raporti vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2020.

Siç ju njoftova edhe më përpara që në mungesë të nënkryetarit për këtë mbledhje, atëherë këtë pikë do ta prezantoj drejtori i Financave.

Afrim Limani – Përshëndetje kryesues, ju anëtarë të KPF-së dhe gjithë të pranishëm në sallë. Siç e tha edhe kryesuesi që në mungesë të nënkryetarit të komunës atëherë këtë pikë do ta prezantoj unë në pika të shkurta dhe të trasha që të bëj një prezantim të raportit të punës të kryetarit të komunës së Rahovecit. Edhe pse ky raport është shumë voluminoz por jemi munduar që në masë të madhe që ta reduktojmë dhe është ky raport që e keni në duart e juaja. Raporti është i përgatitur në bazë të planeve dhe strategjisë që është njehërit edhe ri kapitullim i të gjitha të arriturave që janë bërë gjatë periudhës së vitit 2021. Në pjesën e parë të raportit kemi një ri kapitullim të gjitha të arriturave dhe të gjitha veprimeve të bëra duke përfshirë të gjitha drejtoritë në të

gjitha sektorët ndërsa pjesa tjetër përfshin raportin e punës për çdo drejtori dhe për çdo sektor. Tani nuk dua të zgjatem me shume sa i përket raportit, kështu që i lë hapësirë për debat.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për prezantimin e raportit të punës së kryetarit i cili përfshin periudhën janar – dhjetor 2020, që të gjithë anëtarët e KPF-së e kemi materialin edhe në mënyrë fizike edhe elektronike, që mendoj se janë të paraqitura këtu por ne mbledhjen e kuvendit do të jetë edhe vetë kryetari prezent edhe do të bëjë prezantimin e këtij raporti.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Tek raporti vjetor i punës së kryetarit, mendoj që jeni vonuar shume në hartimin e planit zhvillimor komunal dhe të hartës zonale, që moti e keni paralajmëruar se është gati dhe nuk e keni sjellë në kuvend. Nuk është e mjaftueshme të thoni që Ministria e Ekonomisë dhe e ambientit pritët të japin pëlqimin, pasi duhet të jemi me shume insistues në Ministrinë përkatëse që ta japin pëlqimin pastaj të i hapet rruga shqyrtimit publik dhe të vije sa më shpejt për aprovim. Po ashtu tek faqe 14, tek njësia e auditimit të brendshëm që ju ka raportuar për punën e vet që ka kryer 9 auditime në vitin 2020, por ju kryetar I nderuar nuk na keni informuar për punën e tyre, që edhe ketu në raportin tuaj që na keni sjellë nuk ka të dhëna të hollësishme për punën e njësive të auditimit të brendshëm, se a është bërë auditimi për vitin 2020 apo për vitin paraprak sepse në raportin e fundit të auditorit të përgjithshëm ku ka pasur vërejtje se njësia e auditimit të brendshëm shumicën e auditimeve I ka bërë në vitet e mëparshme e jo në vitet e fundit. Pastaj tek faqe 24, tek drejtoria për shëndetësi nuk e keni cekur mosfunksionimin e qendrës së dializës. Nga qeverisja e kaluar objekti ka qenë I gatshëm dhe u bënë tre vite që po qeverisni dhe jeni në vitin e katërt të qeverisjes dhe ende nuk e keni funksionalizuar repartin e dializës që është aq i nevojshëm për qytetaret që kanë nevojë për këtë lloje shërbimi.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. E kemi përpara raportin vjetor të punës së kryetarit, që ashtu siç e tha kryesuesi është voluminoz dhe unë nuk mendoj me bo shumë ndërhyrje sot pasi nuk e kemi drejtoret për sqarime por do ta diskutojmë me hollësisht në mbledhje të kuvendit. Por tani i kam disa ndërhyrje të vogla që kërkojnë sqarime ku fillimisht vërejtja ime është kjo formë e përgatitjes së raportit në formë 3 mujore të drejtorive që e zgjeron edhe më shumë edhe e bënë voluminoz raportin dhe mendoj se drejtoritë mundën me e përmbledh të gjitha 3 mujoret në raportin vjetor dhe atëherë do të dilte më shkurt dhe nuk besoj që do të mungonte përmbajtja pasi aty duhet të shënohen gjërat më kryesore dhe esenciale. Po ashtu edhe për shkronjat janë të vështirë të lexueshme dhe si duket nuk janë të formës standarde të shkruarit me numër 12 pasi mendoj se është më i vogël dhe është problem edhe me u lexua. Po ashtu kam një ndërhyrje tek faja 13, te zyra për përfaqësim ligjor dhe avokaturë, ku ceket se për seancat e mbajtura në gjyqësor, kontesti civil e përmbarimor që është numri 41 i seancave që janë mbajtur por unë mendoj se këtu duhet të kemi edhe të dhënat se cili është rezultati final i këtyre seancave, pasi sa konteste janë në favor të komunës dhe sa konteste komuna i ka humbur kjo është rëndësi, se vetëm ceket numri i seancave dhe kontesteve që është diskutuar. Pastaj tek drejtoria për shëndetësi, pjesa e qendrës për punë sociale i ka dy apo tre rreshta që mendoj se është i mangët dhe mungon raporti, që në fakt duhet të jetë një raport më i gjerë p.sh. numri i familjeve që marrin asistencë sociale i përgjithshëm, pastaj numri i rasteve që janë kyç brenda atij viti pastaj sa janë që kanë dalë nga ai vit pasi kjo është dinamika dhe lëviz vazhdimisht dhe nuk e kemi atë. Pra, raporti është tejet i shkurtë dhe kërkoj që në mbledhje të jetë më i zgjeruar.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për ju kryesues, drejtorin e Financave, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Faleminderit për prezantimin e raportit nga drejtori Afrim Limani, mendoj që të gjithë pajtohemi se ky raport është mjaft i gjerë dhe është prezantim gjithëpërfshirës dhe i ka përfshi të gjitha ato veprime dhe punë që qeverisja komunale i kryer deri tash gjatë vitit 2020. Unë do të ndalem pak siç e potencoi edhe parafolësi paraprak dhe me gjerësisht sigurisht do të diskutojmë në mbledhje të kuvendit. Në faqe 8, shkruan në pikën e 3-të shkruan janë përfunduar trotuaret në disa vendbanime të komunës tonë dhe i cek si Rahovec, Drenoc, Malësi e vogël, Ratkoc, Opterushë, Celinë dhe Sapniq. Unë dua të jem shumë i sigurtë dhe i drejtpërdrejtë që në Celinë nuk kemi trotuare hiq dhe gjatë kësaj qeverisje 3 vjeçare nuk e di që është bërë ndonjë trotuar diku pasi edhe disa rrugë që i kemi janë të ngushta edhe nuk kanë hapësirë për trotuar mirëpo diku tjetër ku ka mundësi për trotuar nuk është bërë,

kështu që me interesoj se pse është cekur fshati Celinë në këtë raport pasi nuk kemi ndonjë trotuar që është bërë pasi jetoj aty edhe e di që nuk është bërë asnjë trotuar, me përjashtim në qeverisjen e kaluar që është ndërtuar një pjesë te përpjetëza e shkollës kështu që nuk kemi trotuar tjetër të ndërtuar në Celinë, kështu që është mirë me i dhanë të dhënat ashtu siç duhet apo me heqë emrin Celinë pasi nuk ka asnjë trotuar të ndërtuar në fshatin Celinë pasi të mos merret si punë e mirë kryer e në fakt nuk është. Pastaj te Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm isha kureshtarë me ditë se është cekur se e kanë paraqitur punën e vet që i kanë shtyrë vendimet për të gjitha bizneset dhe pastaj ato i kanë krye obligimet e veta për të gjitha bizneset që janë të ngarkuara me taksa afariste komunale edhe është cekur se kemi një rritje të konsiderueshme të të hyrave në taksa afariste komunale, pra desha me ditë se për sa janë rritur taksat afariste komunale dhe është ndonjë dallim i madh më përpara. Pastaj, janë nënshkruar dy marrëveshje të mirëkuptimit në mes kryetarit të Komunës z. Smajl Latifi dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal që kapin vlerë prej 130,000 euro, pra njëra është Renovimi i stacionit të autobusëve dhe i kabinave inovative në shumën 100,000 dhe e dyta është Ndërtimi i rrugës në fshatin Zoqisht që janë paraparë 30,000 euro, pra desha me ditë më shumë rreth këtyre dy projekteve edhe pse aty është e sqaruar pak por deri ku kanë mbërri punimet dhe çka ka mbetur pa u punuar në këtë drejtim. Gjithashtu faqe 41 tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, pra edhe këtu është mirë me përmirësua këtë fjali, pasi këtu shkruan kanë rifilluar punimet në asfaltimin e rrugës Fortesë – Celinë si dhe riparimet e disa gropave në qytet, pra kjo pjesa e dytë riparimi i gropave në qytet është mirë por asfaltimi i rrugës Fortesë – Celinë është mirë të ceket se edhe këtu është riparuar rruga Fortesë – Celinë pasi që fjala asfaltim e nënkupton krejt. Kështu unë e falënderoj shumë drejtorin përkatëse që e ka marrë këtë hapë pasi vërtet na ka mundur me qenë lëvizja më e mirë mirëpo si formulim këtu duhet te jetë e qartë se është bërë riparimi i kësaj rruge e jo asfaltimi i rrugës Fortesë – Celinë.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjetër të lajmëruar, sa për informim të gjitha drejtoritë i kanë edhe të publikuara edhe në webfaqe të komunës për të gjitha aktivitetet dhe punët që po i bëjnë drejtoritë.

Afrim Limani – Në fakt i kam shkruajtur te gjitha pyetjet që ju i parashtruat dhe te gjitha këto do të ju barti kolegëve te mi dhe shpresoj që për mbledhje te kuvendit do të kenë edhe përgjigje adekuate, mirëpo për kureshtje kam edhe dy përgjigje që njëra është për Floriden dhe tjetra për mësuesin Fazli. Pyetja e parashtruar nga Florida ishte për njësinë e auditimit të brendshëm se a është bazuar në baze te raportit të auditimit për vitin 2020 e jo në formën tjetër qysh kanë vazhduar viteve tjera. Njësia e auditimit të brendshëm e ka bërë një punë jashtëzakonisht te mire dhe te madhe për këtë vitin fiskal pasi ka bërë 12 auditime në të gjitha drejtoritë dhe të gjitha i ka bërë për vitin 2020 dhe më dukët një pjesë e mbetur për vitin 2019. Po ashtu një rekomandim që e kemi nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit që lidhet direkt me këtë pyetje që e parashtrove ti dhe ne e konsiderojmë që është rekomandim i zbatuar dhe faktikisht e kanë vërtetuar edhe ata. Po ashtu përgjigje kam edhe për mësuesin në lidhje me dy marrëveshjet, që janë të lidhura nga Komuna e Rahovecit dhe Ministrisë për Stacionin e Autobusëve dhe rruga në Zoqisht. Këto dy projekte kanë përfunduar pra stacioni i autobusëve dhe asfaltimi i rrugës për Zoqisht, mirëpo te stacioni i autobusëve kanë ngelur edhe disa punë te vogla teknike që realisht edhe ato do të kryhen brenda këtij viti. Kurse për pjesën tjetër të pyetjeve që ju i parashtruat të nderuar anëtarë të KPF-së do të ju barti kolegëve te mi dhe besoj që për mbledhje te Kuvendit do të keni përgjigje.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor z. Limani, atëherë të nderuar kolegë meqë nuk kemi pyetje tjera rreth pikës se dytë te rendit të ditës, konstatoj se kalon për kuvend pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2020.

Afrim Limani – Realisht nuk kam edhe shumë për të shtuar rreth kësaj pike pasi materialin e keni marr sot pasi që dje krejt pasdite e kemi finalizuar dhe kërkoj falje për këtë vonesë, gjithashtu e falënderoj edhe kryesuesin që pikërisht për këtë pikë edhe e ka shty edhe seancën duke e ditur që sot apo nesër po barazohemi me Ministrinë e Financave dhe ta bëjmë komplet raportin financiar. Zakonisht raportet financiare vjetore është një procedurë më e gjerë dhe më e madhe dhe e ndërlikuar e sigurisht që marrin kohë edhe përgatitja e tyre, e kjo është edhe arsyeja kryesore që jemi vonuar deri më tani. Mirëpo sa për kureshtjen tuaj edhe pse viti fiskal 2020 ka qenë një vit i vështirë dhe e din të gjithë se jemi përballur me pandeminë Covid-19 edhe kemi pasur vështirësi si në realizim të buxhetit dhe në realizimin e të hyrave por përkundër asaj

konsideroj se ka qenë një vit më i suksesshëm si në inkasimin e të hyrave vetanake e gjithashtu edhe në realizimin e buxhetit. Kemi një ndryshim total të hyrave në raport me vitin e kaluar prej 90,000 euro dhe realizimi i buxhetit ndoshta është viti me i mirë që kemi bërë realizimin e buxhetit diku 97.5% pra pak mjete na kanë shkuar ne suficit afërsisht 30,000 euro që realisht edhe ato i kemi realizua dhe i kemi bo pagesën por për shkak të deficiteve buxhetore nuk ka pasur para shteti dhe ne ditën fundit ata te cilët kanë krye pagesa dhe gjithë ato pagesa nuk janë regjistrua edhe s'kanë kaluar ne xhirollogaritë e partnerëve tanë që i kemi. Pra sikur mos te kish qenë edhe kjo atëherë realizimi i buxhetit do të shkonte mbi 98%. Kështu që për më gjerësisht flasim për ne mbledhje te kuvendit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, është shumë e vërtetë ajo që thatë ju, dje me të marr raportin nga drejtorja e Financave, menjëherë sekretaria e kuvendit ju ka dërguar me email ne mënyrë elektronike se nuk kemi pasur hapësirë që me ju dërgua edhe fizikisht, kështu që besoj që të gjithë do ta mirëkuptoni këtë çështje dhe në kuvend sigurisht se do ta diskutojmë me gjerësisht.

Rasim Fazliu – Siç e ceket edhe ju se raporti na ka ardhur dje pasdite edhe them te drejtën nuk kemi pasur mundësi me shfletua, tani veç e morëm fizikisht mirëpo e dëgjova drejtorin që tha se kemi bërë realizimin e buxhetit për vitin 2020 për 97.5%, kështu që unë e konsideroj se çdo realizim i buxhetit që bëhet mbi 90% gjegjësisht 95% është i suksesshëm për cilën do komunë qoftë ajo, e në këtë rast komuna jonë mendoj që ka bërë një realizim te mirë të buxhetit, në bazë te asaj që këtu na prezantoi drejtori. Kështu nëse shohim tek te hyrat e rregullta dhe të planifikuara për vitin 2020 po shihet që faktikisht është tejkaluar planifikimi d.m.th. realizimi është më i madh se sa planifikimi që është paraparë dhe kjo është mirë edhe është për me përgëzua. Por për me gjerësisht sigurisht se do ta shfletoj dhe do ta analizoj dhe ne mbledhjen e kuvendit do ta japim kontributin tonë aq sa mundemi.

Kryesuesi – Faleminderit z. Fazliu, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar konstatojmë që kalon për kuvend pika e tretë e rendit te ditës. Kalojmë në pikën e katërt te rendit te ditës:

Informatë rreth punës se KKSB-së për gjashtë (6) mbledhjet e vitit 2020.

Kryesuesi – Meqenëse e kemi materialin e informatës rreth punës së KKSB-së që është mbajtur gjate vitit 2020, kryetari i komunës sipas udhëzimeve administrative dhe rregulloreve dhe planit të punës së KKSB-së që i ka mbajtur 6 mbledhje që nëpër secilën mbledhje kanë qenë të gjithë anëtarët e KKSB-së duke përfshirë edhe komandantin e policisë që është anëtar i KKSB-së dhe në secilën mbledhje janë diskutuar dhe janë shqyrtuar për çështjen e sigurisë në komunën tonë. Njëkohësisht në të gjitha takimet kanë marrë pjesë edhe anëtarët e FSK-së, pra në viti 2020 kemi qenë edhe me pjesën e pandemisë ku i është kushtuar një kujdes i madh dhe angazhim i kryetarit së bashku me anëtarët e KKSB-së rreth organizimit rreth takimeve dhe rekomandimeve që kanë ardhur nga IKSHPK-ja. Mendoj që është bërë një punë e mirë rreth KKSB-së dhe për më tepër, ne e kemi pasur materialin dhe kemi mundur me shfletua pak rreth aktiviteteve që i kanë krye KKSB-ja.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, te them te drejtën e kam lexuar me vëmendje dhe është interesant se unë nuk e kam kuptuar mirë apo materiali ka aq shumë gabime që realisht ja humb kuptimin pastaj ka gabime në data, kështu që unë po dua me u koncentrua te çështja p.sh. ku shkruan informatë rreth punës së KKSB-së për gjashtë (6) mbledhjet e vitit 2020, pastaj me poshtë shkruan mbledhjet e mbajtura për vitin 2020 nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi janë dhe pastaj ka vazhdua pika e rendit te ditës e mbledhjes se KKSB-së e mbajtur me 29.01.2019, kështu që vërehet nuk e kuptoj se a është për vitin 2019 apo 2020. Unë ju kisha sugjerua atyre që po ju bëjnë copy paste dokumenteve prej viti ne vit duhet ta kenë parasysh që të ndryshohen datat dhe të mos sillen kështu, pasi është dokument zyrtar që mbetet dhe gjeneratat që e lexojnë pas nuk duhet të bëhen ketë gabime që vërtet me qenë të pakuptueshme. Pastaj ne faqe 2, shkruan sipas statistikave aksidentet me dëme materiale gjate vitit 2019 ka pasur rrënje dhe nëse e krahasojmë me vitin 2018 prapë shkruan, kështu që e gjitha përmbajtja është një raport i para 2 apo 3 vjete dhe na keni sjellë këtu për vitin 2020 e ne fakt bën fjalë për krejt diçka tjetër sepse kur e analizova vërtetë është shqetësuese pasi kjo është në përgjegjësinë e kryetarit të Komunës dhe këtë fjalën rrënje disa here e kam ngritur në këtë sallë dhe duhet të bëhet rënie edhe po ashtu datat dhe vitet duhet te përmirësohen për mbledhje te kuvendit të bëhen 2020. Pastaj në faqe 3, shkruan në mbledhjen që është mbajtur me 12.03.2019, pra, edhe kjo në mbledhjen e parë ka pasur konkluzione të kryetarit kurse në mbledhjen e dytë nuk ka

konluzë nga kryetari dhe unë mendoj që e kemi një zyre për lektorim kurse për data zyra nuk ka faj por ata që i kanë shkruajt datat ashtu kurse për fjalët e shkruajtura gabimisht e kemi zyrën e lektorimit do të ishte mirë me qenë me aktive dhe me përcjell më tepër që nëpër dokumente të këtë sa me pak gabime. Pastaj ne mbledhjen tjetër të tretën me radhë me 22.05.2019, prapë vazhdon me të njëjtat gabime dhe do të ishte mirë që të përmirësohen që për mbledhje të kuvendit me na ardh ne mënyrë të rregullt. Gjithashtu ne faqe 6, kemi diçka rreth pandemisë dhe unë dëshiroj që mos me qenë kështu siç po shkruan këtu sa i përket organizimit të dasmave ahengjeve lejohet 502 persona që me siguri është gabim teknik dhe duhet të jetë 50 persona. Kështu që për te mos qenë i tepërt kërkoj që këto gabime të përmirësohen dhe gjithashtu edhe një rast tjetër kur flet për Covid-19, në faqe 10 shkruan komuna e Rahovecit i ka 287 të shëruar 110 raste aktive, 445 vdekje, a është kjo për gjithë Kosovën apo për komunën e Rahovecit nëse ka mundësi me na tregua rreth kësaj pasi që nuk besoj që qëndron kjo dhe unë po mundohem me dhanë kontributin tim dhe besoj që nuk më keqkuptoni dhe këto janë disa gabime që unë i kam vërejt edhe propozoj që për mbledhje të kuvendit të na vjen dokumenti pa gabime.

Fahrie Lushi – Faleminderit kryesues, i nderur drejtor, te nderuar kolegë të KPF-së. Edhe unë gati sa u inkuadrova me parafolësin pasi është një dukuri që ndoshta edhe nuk duhet me qenë këtu, duke filluar me gabime drejtshkrimore në faqen e parë e me pastaj me data e numra sepse e kam përcjellë shume mirë dhe çdo gjë ka qenë e kurtë. Mirëpo qysh në faqen e parë të këtij raporti të KKS-së, në vend që të shënohet të rendit, e kemi ne të gjitha pikat të rendit pastaj ne rreshtin pasues e cila ka qenë ne kohën e kur është mbajtur takimi, kështu që e kur duhet të largohet. Pra, janë me mijëra gabime të tilla që thjesht ja humbin kuptimin edhe të leximit e assesi me i dhanë kuptim këtij raporti, kështu që lektoren e kemi edhe thjesht duhet me qenë më e përgjegjshme sepse atë lektore e kemi shpërblye edhe me një çmim të poezive pasi ajo merret edhe me shkrime edhe thjesht ne e cilësojmë si lektore dhe i duam këto sqarime dhe këto korrigjime. Pastaj ajo që është për tu çuditur është përsëritja e rendit, diskutimeve pastaj gjithmonë, kështu që janë gabime që nuk tolerohen edhe nuk i japin kuptim asaj fjalisë e assesi një raporti të tillë.

Kryesuesi – Faleminderit znj.Lushi, atëherë meqë nuk kemi tjetër të lajmëruar rreth pikës së katërt të rendit të ditës, konstatoj se kalon për kuvend. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Mirsad Shala – Përshëndetje për ju kryesues, përshëndetje për ju anëtarë të KPF-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. Siç e dini komuna e Rahovecit e ka formulua një rregullore për përkujdesjen e fëmijëve e cila i ka kaluar të gjitha procedurat dhe me këtë rast pritet që nga ana juaj vetëm të diskutohet dhe të aprovohet në kuvendin e radhës.

Kryesuesi – Faleminderit z. Shala, ne e kemi pasur edhe në muajin nëntor këtë draft rregullore që ta merr aprovimin nga kuvendi për dalje në publik dhe mendoj që kjo rregullore i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore dhe e kemi diskutuar edhe atëherë që është rregullore e cila është në nivel të Republikës së Kosovës që të jetë si rregullore e njëjtë për të gjitha komunat për të drejtat e fëmijëve. Nëse nuk ka dikush diçka sa i përket pikes së pestë, atëherë e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit të ditës dhe kalon për kuvend. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P – 71510066 – 00386-1.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. Para jush keni propozim vendimin e kryetarit të komunës sipas ligjeve ne fuqi për shpalljen me interes e përgjithshëm të një parcele e cila gjendet në zone kadastrale në Pastasel. Bëhet fjalë për parcelën P – 00386-1 me sipërfaqe prej 2 hektar e 20 ari 0,5m2. Kjo është prone shtetërore KK.Rahovec dhe shfrytëzues është ekonomia e pyjeve në Rahovec.Me kërkesën e këshillit të fshatit Pastasel kanë kërkuar prej neve që prej kesaj sipërfaqe të kufizojm një parcelë ne sipërfaqe prej 10 ari. Kemi dal me gjeodetë atje edhe e kemi kufizuar dhe qellimi apo kërkesa e këshillit është që aty të caktohet një lokacion ku ata pastaj do të ndërtojnë një shtëpi që do të gjendet ne sherbim të komunitetit të fshatit Pastasel. Ftojë anëtarët e KPF-së që të aprovjnë pikën që pas shqyrtimit të votojnë dhe të dergojnë në kuvend pikën e rendit të ditës.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e falenderoj edhe drejtorin për prezantimin e kësaj pike. Është krijuar si model nëpër të gjitha fshatrat për ndërtimin e objekteve të përgjithshme për fshat. Unë vetëm desha t'i them drejtorit që për mbledhje të kuvendit do të ishte mirë me na sjellë edhe kërkesën e fshatit që me ja bashkëngjitë që ta kemi si të plotësuar, kështu që do ta mbështesim kur të vjen koha.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, ashtu siç u tha edhe nga parafolësi kjo punë tash po shkon pothuajse ne secilin fshat për objekte të tilla për destinime të caktuara dhe unë mendoj se nëse këshilli i fshatit e ka menduar se kjo është e dobishme dhe në interes të fshatit, atëherë ne duhet të jemi pro kësaj dhe ta procedojmë ne mbledhjen e ardhshme por kur po e shoh se këto po bëhen me rend dhe do të bëhen edhe të tjera, kam një pyetje rreth kësaj pasi këto të ndërtohen atëherë kush do të përkujdeset për mirëmbajtjen e tyre e këtyre objekteve, pasi objekti ndërtohet, shfrytëzohet por edhe pjesa e mirëmbajtjes edhe ajo e ka pjesën e shpenzimeve të veta. A keni biseduar si komunë dhe si ekzekutiv apo drejtori me këshillat e fshatrave se si do të bëhet rreth kësaj çështje?

Afrim Oruqi – Ne kemi biseduar fillimisht për fshatin Radoste dhe tash jemi ne pregaditjen rregullimit të dokumentacionit dhe drejtorja e administratës ka bërë kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit fillimisht me objektin që e kemi ndërtuar ne Radoste që me pajisë me leje. Pastaj prona e këtij objekti në Radoste, Gexhë dhe tash jemi ne Pastasel ka me vazhdua me qenë pronë shtetërore e Kosovës ndërsa mirëmbajtjen dhe kujdesin ka me marr drejtorja e Administratës edhe do të kujdeset rreth shpenzimeve të ujit, rrymës etj. Tash ne veç po bëjmë një zgjidhje për shkak se tash si komunë për momentin nuk mundemi me i ndërtuar vetë pasi ata me mjete vetanake dhe vullnetare po organizohen por objekti ka me u regjistrua si aset i komunës se Rahovecit dhe kujdesin dhe mirëmbajtjen do të jet e obliguar me i krye për te gjitha shpenzimet dhe prona ka me vazhdua me qenë pronë e Kosovës, pra drejtorja e Administratës ka me vazhdua me i krye këto punë ne te ardhmen.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për kuvend pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

Shqyrtimi i Raportit të punës se Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2020.

Kryesuesi – Për këtë mbledhje nuk e kemi anëtarin e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe mirëpo ne e kemi përpara një raport të cilin ata e kanë sjellë për aktivitetin e tyre të cilat i kanë bërë gjatë vitit 2020. Ndërsa për mbledhje të Kuvendit do ta kemi prezent edhe anëtarin këshillit të fshatit Hoçë e Madhe dhe do të na prezantojë raportin e punës dhe aktiviteteteve që i kanë kryer.

Rasim Fazliu – Unë e kam pa atë fletë që na keni sjellë mirëpo më së paku atij mundemi me i thanë raport e madje as informatë nuk është, më shumë duket si gjysmë informatë sepse fjala raport e ka kuptimin me elaborue diçka në mënyrë të thukshme edhe të tërësishme me prezantua diçka, kështu që do të ishte mirë me qenë tamam raport mirëpo megjithatë i falënderojmë edhe për atë fletë që na kanë sjellë.

Kryesuesi – Faleminderit z. Fazliu, atëherë meqë nuk tjetër të lajmëruar, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

Të ndryshme.

Të nderuar kolegë kuvendarë, unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi

Agim Hoti

